

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Nr. 437 Prot.

Rrogozhinë, më 30/01/2026

PROJEKT- VENDIM

Nr. ___ datë __. __. 2026

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR “PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA”

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja “b”, nenin 24 pika 2, në Ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 454, datë 3.7.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, Vendimi i Këshillit të Bashkisë Rrogozhinë nr. 52 datë 24.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Rrogozhinë , Vendimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë me Nr. 30 , datë 19.08.2025 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “Përmirësim I kushteve të banesave ekzistuese ”, Vendimin e Komisionit të Strehimit nr. 3 datë 16.01.2026, shkresës së ardhur nga Ministria Ekonomisë dhe Inovacionit me nr 423 prot datë 28.01.2026 për projektet e investimeve që do të financohen nga Buxheti i Shtetit për vitin 2026-2027, bazuar në relacionin e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Kujdesit Social, Këshilli i Bashkisë Rrogozhinë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e familjeve që do të përfitojnë nga programi për "Përmirësimin e hanesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuar" sipas tabelës 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Konc.
Ledian Hasani



KRYETAR

Edison MEMOLLA

Në mungesë dhe me Urdhër

M kryetar
Andi Proshka




Tabela nr. 1

Lista e familjeve për t'u trajtuar nga programi për "Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara"

| Nr | Emër Atësi Mbiemër (kryefamiljari) | Nr. total i anëtarëve në familje, sipas certifikatës familjare të 3 muajve të fundit | Kategoria së cilës i përket, sipas nenit 16 të ligjit nr. 22/2018 | Niveli i të ardhurave mesatare mujore të familjes | Lloji i dokumentit të pronësisë | Numri i pasurisë dhe zona kadastrale, sipas dokumentit të pronësisë | Sipërfaqe e objektit ekzistues (m2) | Vlera e financimit |
|----|------------------------------------|--|---|---|---------------------------------|---|-------------------------------------|--------------------|
| 1 | Latif Kadri Dedej | 3 anëtar | Jo status i veçantë | Familjarë me të ardhura shumë të ulëta. | Çertifikatë pronësie | Nr i pasurisë 4/106-nd Zona kadastrale Nr 3234 | 130.8 m2 | 1,300,000 lekë |
| 2 | Sulejman Qazim Hasalla | 4 anëtar | I moshuar/2 Familjarë me aftësi të kufizuar | Familjarë me të ardhura shumë të ulëta. | Çertifikatë pronësie | Nr i pasurisë 4/337+1-1 Zona kadastrale Nr 3234 | 35 m2 | 2,000,000 lekë |
| 3 | Fisnik Lutfi Haka | 2 Anëtar | Jo status i vecante | Familje me të ardhura shume te ulëta | Certifikate pronësie | Numer i pasurise 96/1 Zona kadastrale Nr 2538 | 152 m2 | 1,000,000 leke |

| | | | | | | | | |
|---|-------------------|----------|---------------------|---|----------------------|--|--------------|----------------|
| 4 | Arta Hekuran Sula | 2 Anetar | Jo status i veçantë | Familjarë me te ardhura shumë të ulëta. | Çertifikatë pronësie | Numer i pasurise 84/24 Zona kadastrale Nr 3450 | 114.4 m2 | 1,000,000leke |
| | | | | | | | Shuma Totale | 5,300,000 lekë |

Nr 497/1 prot Dt. 30.01.2026

RELACION PËR PROJEKT-VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR

“PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA”

Të nderuar Këshilltarë!

Po ju a risjellim këtë projekt vendim për ndryshimet e bëra bazuar në shkresën e ardhur nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me nr.423 prot datë 28.01.2026 për projektet e investimeve që do të financohen nga Buxheti i Shtetit për vitin 2026-2027 ku në kostot e financimit për çdo familje ndryshojnë vlerat e granteve. Bashkia Rrogozhinë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja “b”, nenin 24 pika 2, në Ligjin nr. 22/2018 “Për Shtetin Social” i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018”, Vendimin e Këshillit të Ministrave

Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", Vendimin e Komisionit të Strehimit nr.3 datë 16.01.2026 , paraqet për votim projekt vendimin për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për "përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara.

Programi i përmirësimit të kushteve të banimit është pjesë e programeve të strehimit social i cili shërbejnë për familjet dhe të individëve që banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të amortizuar , në kuptim ligjit për strehimin social dhe që nuk kanë mundësi ekonomike e financiare për përmirësimin e kushteve të jetesës.

Bashkia Rrogozhinë edhe për këtë vit ju përgjigj pozitivisht kërkesës së Ministrisë së Financave për të aplikuar dhe të perfitoj fondet në kuadër të thirrjes "Për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2026".

Duke u nisur nga kërkesat e qytetarëve, banesat e të cilëve janë të amortizuara dhe jashtë kushteve teknike, Bashkia Rrogozhinë për këtë vit po kryen të gjitha procedurat dhe përgatitjen e dokumentacionit për të aplikuar për këtë projekt. Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social në Bashkinë Rrogozhinë mori në shqyrtim kërkesën e 4 (katër) aplikantëve.

Fillimisht është bërë shqyrtimi i dokumentacionit për secilin qytetar/familje aplikant dhe duke zbatuar parashikimet ligjore të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese , u hartua lista dhe u krye renditja e aplikantëve.

Komisioni i Strehimit me Vendim Nr 3 datë 16.01.2026 vendosi të kualifikojë 4 aplikantë nga 7 që kishin aplikuar, 3 aplikantë u kualifikuan për shkak se banesat i përmbushnin kushtet për të qenë të banueshme. Aplikantët që nuk përfitojnë janë, Shefqet Hamid Dushku ,Sali Ahmet Aliu , dhe Edmond Shefit Beu .Familjet jo përfituese janë njoftuar me anë të shërbimit Postar për vendimin e marrë nga ana jonë .Komisioni u bazua në proces-verbalet e grupit të punës me nr 380 datë 13.10.2025 ngritur nga Kryetari I Bashkisë Rrogozhinë dhe proces-verbalet e grupit të punës të ngritur me Urdhër nr.7,prot datë 12.01.2026 "Për ngritjen e Komisionit për riferifikimin e gjendjes faktike të objekteve në lidhje me ankesat e qytetarëve " ,ku për çdo familje janë bërë konstatimet përkatëse.

Të gjithë aplikantët e kualifikuar kanë banesat me probleme të theksuar me lagështinë në atë nivel sa rrezikohet dhe ana shëndetësore e familjarëve që jetojnë në këto banesa. Duke qenë se aplikantët i përkasin kategorisë me të ardhura shumë të ulëta dhe një prej tyre kanë në përbërjen dy familjarë me aftësi të kufizuar mundësia financiare e tyre është shumë e ulët që ata të arrijnë të bëjnë rregullimet që iu nevojiten banesave.

Theksojmë se aprovimin përfundimtar të familjeve aplikuese e vendos Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Sherbimit Mbrojtjes dhe Kujdesit Social pasi kryen shqyrtimin e dokumentacionit të aplikimit nga bashkia për këtë program.

Nga programi i përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese do të trajtohen, 4 familje të cilat i përmbushin kriteret për tu kualifikuar, me një shumë totale prej 5,300,000 lekë sipas tabelës nr.1 pjesë përbërëse të projekt vendimit.

Për sa shpjeguar më lartë, propozojme votimin e projekt vendimit " Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për "përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitet e varfëra dhe të pa favorizuara".

Drejtori I Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Ledian Hasani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Nr. 438 / Prot.

Rrogozhinë, më 25 / 04 / 2026

Projekt-Vendim

Nr. ___ datë __. __. 2026

“PËR MIRATIMIN NE PARIM TË DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR “PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PER VITIN 2026”

Mbështetur në shkresën e ardhur nga Ministria e Ekonomisë ,Kulturës dhe inovacionit me nr me nr 423 prot datë 28.01.2026 për projektet e investimeve që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2026-2027. Bashkia Rrogozhinë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” nenin 8,pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja “b”, nenin 24 pika 2 , në Ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”i ndryshuar me ligjin nt.48/2023 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 454, datë 3.7.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”. I propozojmë Këshillit Bashkiak



Të Vendosi


1. Miratimin në parim të deklaratës për bashkëfinancim të familjeve që do përfitojnë nga programi "Përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese për komunitet e varfëra dhe të pafavorizuara " për aplikim sipas shpalljes së thirrjeve për bashkëfinancim , për rikonstrukcion të banesave në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.
2. Marrjen përsipër në momentin e fitimit të projektit të vlerës që i takon bashkëfinancimit të Bashkisë, 2,120.000(dy milion e njëqind e njëzet mijë) lekë, nga zëri buxhetor 00 / 1110 / 05 / 2312118, pra 40% e vlerës totale 5 300 000 (pesë milion e treqind mijë) lekë të preventivit të projektit të pasqyruar në projekt vendimin e 4 (katër) familjeve përfituese për vitin 2026 .ku 3 180 000 (tre milion e njëqind e tetë dhjetë mijë) lekë ose 60 % të vlerës e mbulon Ministria Ekonomisë,Kulturës dhe Inovacionit.

Konc.
Ledian Hasani

Në mungesë dhe me Urdhër

N/kryetar

Andi Proshka



Nejsh
me origjinalin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

1198

Nr. ___ Prot.

Rrogozhinë, më 30 / 01 / 2026

DEKLARATË

Nr. ___ datë __. __. 2026

“PËR BASHKËFINANCIM TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR “PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESË PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PER VITIN 2026”

Mbështetur në shkresën e ardhur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr me nr-423 prot datë 28.01.2026 për projektet e investimeve që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2026-2027.

1. Miratimin në parim të deklaratës për bashkëfinancim të familjeve që do përfitojnë nga programi” Përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese për komunitet e varfëra dhe të pafavorizuara ” për aplikim sipas shpalljes së thirrjeve për bashkëfinancim , për rikonstrukcion të banesave në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.

2. Marrjen përsipër në momentin e fitimit të projektit të vlerës që i takon bashkëfinancimit të Bashkisë. 2.120.000(dy million e njëqind e njëzet mijë) lekë. nga zëri buxhetor 00 / 1110 / 05 / 2312118, pra 40% e vlerës totale 5 300 000 (pesë million e treqind mijë) lekë të

preventivit të projektit të pasqyruar në projekt vendimin e 4 (katër) familjeve përfituese për vitin 2026 ,ku 3 180 000 (tre milion e njëqind e tetë dhjetë mijë) lekë ose 60 % të vlerës e mbulon Ministria Ekonomisë,Kulturës dhe Inovacionit.


Konc.
Ledian Hasani



Në mungesë dhe me Urdhër

Andi Proshka

Andi Proshka



K R Y E T A R

Edison MEMOLLA

Nr. 4941 prot

02.30.01.026

RELACION PËR PROJEKT -VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN NE PARIM TE DEKLARATËS PER BASHKEFINANCIM TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR “PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PER VITIN 2026”

Të nderuar Këshilltarë!

Po ju a risjellim për miratin projekt-vendimin për deklaratën e bashkëfinancimit për ndryshimet e bëra bazuar në shkresën e ardhur nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me nr.423 prot datë 28.01.2026 për projektet e investimeve që do të financohen nga Buxheti i Shtetit për vitin 2026-2027 ku në kostot e financimit për çdo familje ndryshojnë vlerat e granteve dhe % që i takon Bashkisë Rrogozhinë. Bashkia Rrogozhinë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” nenin 8.pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja “b”, nenin 24 pika 2, në Ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar me ligjin nr.48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 454, datë 3.7.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”.

Bashkia Rrogozhinë edhe për këtë vit ju përgjigj pozitivisht kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për të aplikuar dhe të perfitoj fondet në kuadër të thirrjes "Për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2026".

Duke u nisur nga kërkesat e qytetarëve, banesat e të cilëve janë të amortizuara dhe jashtë kushteve teknike, Bashkia Rrogozhinë për këtë vit po kryen të gjitha procedurat dhe përgatitjen e dokumentacionit për të aplikuar për këtë projekt. Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social në Bashkinë Rrogozhinë mori në shqyrtim kërkesën e 4 (katër) aplikantëve.

Theksojmë se aprovimin përfundimtar të fondit e vendos Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Sherbimit Mbrojtjes dhe Kujdesit Social pasi kryen shqyrtimin e dokumentacionit të aplikimit nga bashkia për këtë program.


Nga programi i përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese do të trajtohen, 4 familje të cilat i përmbushin kriteret për tu kualifikuar, me një shumë totale prej 5,300,000 lekë ku Bashkia Rrogozhinë merr përsipër në momentin e fitimit të projektit të vlerës që i takon bashkëfinancimit të Bashkisë, 2,120,000 (dy milion e njëqind e njëzet mijë) lekë, nga zëri buxhetor 00 / 1110 / 05 / 2312118, pra 40% e vlerës totale 5 300 000 (pesë milion e treqind mijë) lekë të preventivit të projektit të pasqyruar në projekt vendimin e 4 (katër) familjeve përfituese për vitin 2026 ,ku 3 180 000 (tre milion e njëqind e tetë dhjetë mijë) lekë ose 60 % të vlerës e mbulon Ministria Ekonomisë,Kulturës dhe Inovacionit.

Për sa shpjeguar më lartë, propozojme votimin e **"PROJEKT-VENDIMIT PËR MIRATIMIN NE PARIM TE DEKLARATËS PER BASHKEFINANCIM TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR "PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PER VITIN 2026"**

Drejtori I Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Ledian Hasani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 537 .Prot.

Rrogozhinë, më 03.02.2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. , datë 03.02.2026

**PËR MIRATIMIN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR VERIFIKIMIN E
PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT E DËMTUARA NGA TËRMETI I
DATËS 26 NËNTOR 20219 ME NIVEL DËMI DS4, DS5 NË BASHKINË RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", nenit 54 gërma "a", të nenit 55 pika 3, të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore " i ndryshuar, Rregullores "Për organizmin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë", mbi bazë të propozimeve të bëra nga Këshilltarët dhe grupeve politike i propozojmë, Këshillit Bashkiak,

T Ë V E N D O S I :

1. Miratimin e Komisionit të përkohshëm të Këshillit Bashkiak, për verifikimin e procesit të rindërtimit për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 me nivel dëmi DS4,DS5 në Bashkinë Rrogozhinë me këtë përbërje :

| | | |
|----------|---------|-----------------|
| - Mitat | Daja | Kryetar |
| - Shpati | Kolgega | Zëvendëskryetar |
| - Indrit | Dedej | Anëtar |
| - Renato | Kalemi | Anëtar |
| - Altin | Tosku | Anëtar |

2. Ngarkohet ky komision që brenda datës 15 Shkurt 2026, të hartojë një plan verifikimi të detajuar mbi objektin e verifikimit që synon dhe të gjithë veprimtarinë e tij, deri dhe në kohëzgjatjen e funksionimit të këtij komisioni.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

3. Komisioni pas përfundimit të verifikimit i paraqet Këshillit raportin përfundimtar të verifikimit, i cili përmban konkluzionet e verifikimit, provat që kanë çuar komisionin në këto konkluzione, si dhe propozime për zgjidhjen e çështjes nëse ka.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i përkohshëm i Këshillit Bashkiak për verifikimin e procesit të rindërtimit për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 me nivel dëmi DS4, DS5 në Bashkinë Rrogozhinë.
5. Ky projektvendim, pas miratimit në këshill hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARE E GRUPIT TË DJATHTË
SILVANA ALIU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 537/1.Prot.

Rrogozhinë, më 03.02.2026

RELACION SHPJEGUES

**PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E KOMISIONIT TË PËRKOSSHËM
PËR VERIFIKIMIN E PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT E DËMTUARA
NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 20219 ME NIVEL DËMI DS4, DS5 NË
BASHKINË RROGOZHINË”**

Të nderuar Këshilltarë,

Propozimi për miratimin e projektvendimit, “Për miratimin e Komisionit të përkohshëm të Këshillit Bashkiak, për verifikimin e procesit të rindërtimit për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 me nivel dëmi DS4, DS5 në Bashkinë Rrogozhinë”, lind për arsye të disa ankesave të qytetarëve të ndryshëm të Bashkisë tonë së fundmi të bëra dhe mediatike, të cilët ende mbeten pa banesë që nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019. Sipas tyre firma e ndërtimit që duhej të përfundonte banesat e tyre i ka mashtruar dhe nuk ka kryer punimet e nevojshme duke ndikuar ndjeshëm në cilësinë e jetës së këtyre banorëve.

Pas ngritjes së këtij komisioni brenda datës 15 Shkurt do të përpilohet një plan verifikimi i detajuar mbi hapat që do të ndjekë komisioni për të verifikuar se ku ky proces ka çaluar dhe të rekomandojë sipas rastit zgjidhje të çështjes nëse ka dhe nëse e gjykon të arsyeshme.

Sa më lart i propozojmë këshillit bashkiak miratimin e këtij projektvendimi për t'i ardhur sado pak në ndihmë komunitetit për këtë çështje tepër të rëndësishme.

Duke ju falenderuar pwr mirwkuptimin.

KRYETARE E GRUPIT TË DJATHTË

SILVANA ALIU